



INSTITUTI I STUDIMEVE EVROPIANE
UNIVERSITETI I TIRANËS

AVOKATI I POPULLIT



Nr. 56 Prot., datë 19.02.2021

Nr. 95 Prot., datë 19.02.2021

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT

dhe

INSTITUTIT TË STUDIMEVE EVROPIANE

PRANË UNIVERSITETIT TË TIRANËS

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Për institucionalizimin e marrëdhënieve ndërmjet:

INSTITUCIONIT TE AVOKATIT TE POPULLIT

dhe

INSTITUTIT TE STUDIMEVE EUROPIANE PRANË UNIVERSITETIT TË TIRANËS

Institucioni i Avokatit të Popullit, përfaqësuar nga **Avokati i Popullit Zj. Erinda BALLANCA**, me adresë në Blv. "Zhan D'Ark", Nr.2, Tiranë,

dhe

Instituti i Studimeve Europiane pranë Universitetit të Tiranës, përfaqësuar nga drejtori **Prof. Dr. Aljula JUBANI**, me adresë: Rr. "Elbasanit", Tiranë (në vijim "Palët"):

Duke vlerësuar si prioritet të përbashkët garantimin dhe respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të individit, si dhe interesave të tjera të ligjshme të tij;

Duke konsideruar qëllimin e përbashkët për realizimin e interesave të ligjshme të individëve mbështetur në parimet e barazisë së të drejtave për të gjithë individët;

Bazuar në nenin 29 të ligjit nr. 8454, datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, si dhe nenin 3 të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", palët kanë rënë dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (në vijim "Marrëveshje").

Neni 1

Objekti i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka për qëllim, institucionalizimin e bashkëpunimit të Institucionit të Avokatit të Popullit me Institutin e Studimeve Europiane pranë Universitetit të Tiranës, në kuadër të veprimtarive të përbashkëta për:

- ndërgjegjësimin e institucioneve shtetërore, organizatat e shoqërisë civile dhe publikun, me qëllim: mbrojtjen, respektimin, promovimin dhe nxitjen e standarteve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend;
- përfshirjen në kurrikulat mësimore të Institutit të Studimeve Europiane pranë Universitetit të Tiranës, të moduleve të veçantë, që kanë për qëllim zgjerimin e

njohurive të studentëve në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, të parashikuara në Kushtetutën e Republikës Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptarë dhe në legjislacionin vendas në fuqi;

- në organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve në fusha me interes të përbashkët.
- hartimin e materialeve studimore (raporteve), të përbashkëta.

Neni 2

Forma e bashkëpunimit

Marrëveshja do të zbatohet midis palëve të lartëpërmendura në fushën e kësaj marrëveshje për të përmbushur objektin e saj.


Në këtë kuadër,

Avokati i Popullit merr përsipër:

1. Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta ndërgjegjësuese në nivel kombëtar me stafin akademik, pedagogët dhe studentët e Institutit të Studimeve Europiane pranë Universitetit të Tiranës, me tematika të ndryshme që lidhen me fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut në vendin tonë dhe në vecanti, rritjen e rolit të qytetarëve për pjesmarrjen në vendimarrjet e organeve të administratës publike në nivel qendror dhe vendor. Përdorimin e logove të institucioneve gjatë zhvillimit të aktiviteteve përbashkëta.
2. Kryerjen e praktikave mësimore dhe intershipe të studentëve të Institutit të Studimeve Europiane, pranë institucionit të Avokatit të Popullit, si dhe vënien në dispozicion të studentëve për nevoja studimore dhe kërkimore të literaturës në Qendrën e Dokumentacionit për të Drejtat e Njeriut pranë Avokatit të Popullit.
3. Shkëmbimin e literaturave vendase dhe ndërkombëtare (përfshirë edhe atë elektronike), në fushën e jurisprudencës dhe të së drejtës vendase dhe ndërkombëtare, për fushën e të drejtave të njeriut.
4. Të ofrojë sipas mundësive, leksione të hapura me studentët e Institutit të Studimeve Europiane, nga ekspertë të Institutit të Avokatit të Popullit, mbi bazën e temave të rëna paraprisht dakord.

Instituti i Studimeve Europiane pranë Universitetit të Tiranës merr përsipër:

1. Të kontribuojë me punime të pedagogëve dhe studentëve, si dhe prezantimin e tyre në aktivitete e përbashkëta që do organizojë Instituti i Studimeve Europiane me institucionin e Avokatit të Popullit, në fushën e mbrojtjes, respektimit dhe promovimit të të drejtave të njeriut në vend.
2. Të verë në dispozicion ambientet e Institutit të Studimeve Europiane, për aktivitete me qëllime të përbashkëta.



3. Të njoftojë stafin e pedagogëve dhe studentëve mbi mundësinë e praktikave dhe internshipe-ve pranë institucionit të Avokatit të Popullit.
4. Në kuadër të programeve të studimit të doktoraturave, të bashkëpunojë me nëpunësit e institucionit të Avokatit të Popullit, që kanë fituar të drejtën të ndjekin ciklin e tretë të studimeve universitare, në përputhje me kushtet e parashikuara nga Rregullorja e miratuar nga Senati Akademik i Universitetit të Tiranës "Për organizimin e programeve të studimit të doktoratave".

Neni 3

Komunikimi mes palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve të tyre.
2. Secila Palë do të caktojë një person kontakti që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret të Marrëveshjes dhe të shkëmbimit të informacionit.
3. Komunikimi ndërmjet palëve do të jetë në formë shkresore. Në rastet kur kërkohet, komunikimi mund të bëhet në mënyrë elektronike dhe verbale përmes personave të kontaktit.
4. Personat e kontaktit do të jenë të disponueshëm në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin me palën tjetër me qëllim rakordimin e veprimeve që duhet të ndërmerren rast pas rasti.

Neni 4


Kostot financiare

Secila palë merr përsipër kostot financiare të nevojshme dhe të domosdoshme për zbatimin e kësaj marrëveshje.

Neni 5

Dispozitat e fundit

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh.
2. Ndryshimet mund të bëhen me marrëveshje nga Palët nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim duke saktësuar datën e hyrjes në fuqi.
3. Çdo mosmarrëveshje krijuar mbi interpretimin ose ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.
4. Përveç parashikimit të paragrafit 1 të këtij neni, kjo Marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë, duke njoftuar paraprakisht me shkrim 60 ditë përpara, palën tjetër.




5. Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale, njëra për Avokatin e Popullit dhe tjetra për Institutin e Studimeve Europiane pranë Universitetit të Tiranës.

Kjo Marrëveshje bashkëpunimi nënshkruhet sot në Tiranë, në datë ____ Shkurt 2021.

Avokati i Popullit


Erinda BALLANGA

Drejtor i Institutit të Studimeve Europiane
pranë Universitetit të Tiranës


Prof. Dr. Aljula JUBANI